

LISBON, 10 Shkurt (Lajme nga ILO) – Takimi i 8-të Rajonal Evropian i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) u hap sot me një thirrje për një përqasje të integruar me qëllim ndalimin e pershëllëzimit të ngadalësimit ekonomik dhe ndërtimin e një ekonomie më të fortë, më të pastër dhe më të drejtë për të ardhmen.

Duke cituar parashikime të fundit të ILO-s se papunësia globale mund të rritet me 50 milionë të papunë për shkak të rënies ekonomike, Drejtori i Përgjithshëm i ILO-s z. Juan Somavia tha se rreth 8 milionë persona ose një e pesta e numrit total mund të jenë nga 51 vendet anëtare në rajonin e Europës dhe Azisë Qendrore – dhe rreth gjysma e tyre mund të vijnë nga 27 vendet anëtare të BE-së.

“Këtë nuk e them me një ndjenjë dëshpërimi, por me një ndjenjë besimi se bota, duke vepruar bashkarisht, mund ti përmbysë këto prirje”, tha Z. Somavia.

Duke ju drejtuar në sallën e konferencës përfaqësuesve të punëmarrësve, punëdhënësve dhe qeverive nga vendet anëtare të rajonit, si dhe Kryeministrit të Portugalisë, Shkëlqesisë së Tij Z. José Socrates dhe më shumë se 30 Ministrave të Punës apo Sekretarë Shteti, Drejtori i Përgjithshëm i ILO-s tha se kriza ekonomike është “duke u përkeqësuar më tej drejt një reçesioni të mundshëm global social që do të provokonte tensione, pasiguri politike dhe ndoshta edhe rreziqe të mundshme përsa i përket sigurisë”.

Z. Somavia përmendi gjashtë fusha në të cilat qeveritë, punëdhënësit, punëmarrësit dhe ILO duhet të përqendrohen: garantimi i fluksit të kredive dhe stimulimi i kërkesës; zgjerimi i mbrojtjes sociale dhe politikave të punësimit duke treguar vëmendje të veçantë për personat e dobët; mbështetja e ndërmarrjeve produktive, veçanërisht atyre të vogla; garantimi i respektimit dhe promovimit të parimeve themelore dhe të drejtave në punë; thellimi i dialogut social dhe tripartizmit; dhe ruajtja dhe zgjerimi i ndihmës për zhvillim si dhe i flukseve të tjera të investimit për vendet e dobëta.

“Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore duhet të luajë një rol drejtues duke u përballur në mënyrë koherente me problemet e ndryshme të tyre në vende të ndryshme dhe gjithashtu duhet të ndihmojë në ndërtimin e një përqasjeje të kordinuar globale”, tha ai. “Mendoj se rajoni juaj mund të luajë një rol të veçantë në arritjen e një politike më koherente dhe bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për shmangien e politikave protektioniste që mund të dalin në pah.”

Në deklaratën e tij në sesionin plenar, Kryeministri i Portugalisë tha se: “Ishte Evropa ajo – që si pjesë e procesit të saj ambicioz të integritit –ndërmorri hapat më të qëndrueshme drejt ndërtimit të një modeli social të balancuar dhe përfshirës. Dhe është dhe Evropa e sotme që ka një përgjegjësi më të madhe për miratimin e përgjigjeve efikase dhe të drejta ndaj krizës aktuale dhe sfidave me të cilat përballemi sot në botën e punës, duke mbështetur mbrojtjen sociale dhe dialogun social”.

Z. Somavia tha se kriza aktuale, e dhimbshme sikurse është, paraqet mundësi për gjetjen e zgjidhjeve afatgjata, të cilat shkojnë përtej rregullimit të sistemit financiar dhe bankar, dhe ju referua Axhendës së Punës së Denjë të ILO-s si një guidë praktike për të ecur përpara.

“Një përjasje investimi social bazuar në Axhendën e Punës së Denjë të ILO-s ofron një lehtësim të menjëhershëm në lidhje me gjenerimin e mundësive të punësimit dhe një bazë sociale dhe ekonomike për fuqizim dhe mundësi për të reaguar ndaj varfërisë që po shtohet. Por ajo gjithashtu ka për qëllim forcimin e ekonomive në të ardhmen nëpërmjet trajnimit, një infrastrukturë e re për një ekonomi më “jeshile” dhe për mbështetje ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, ka thënë ai.

Z. Somavia tha se kriza aktuale ka nxjerrë në pah jo vetëm një boshllëk global politikash por gjithashtu edhe një vakum institucional “për të përballuar reçesionin e parë në erën e globalizimit”.

“Themelore për kapacitetin tonë për të menduar dhe punuar së bashku janë vlerat dhe angazhimet tona të përbashkëta për të garantuar një petk moral të ekonomisë globale”, tha ai.

“Neve do të na duhet të jemi jashtëzakonisht vigjilentë në drejtim të rigjallërimit të reagimeve politike ndaj pasigurisë dhe shqetësimeve ekonomike nën formën e urrejtjes racore dhe fetare, diskriminimit kundër imigrantëve apo minoriteteve etnike, viktimizimit të përfaqësuesve të sindikatave dhe politikave ekonomike protektioniste të cilat do të përkeqësonin krizën”, konkludoi Z. Somavia.

Vendet anëtare të ILO-s nga rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore takohen çdo katër vjet për të hartuar politika dhe për të përcaktuar prioritetet për fushën.

Në këtë takim u dëgjuan gjithashtu edhe Deklarata nga Z. Daniel Funes de Rioja, Zëvendës – Kryetar për Punëdhënësit në Organizmin Qeverisës të ILO-s, Z. Roy Trotman, Zëvendës – Kryetar për Punëmarrësit në Organizmin Qeverisës të ILO-s, Znj Renate Hornung Draus, Zëvendës presidente për Europën e Organizatës Ndërkombëtare të Punëdhënësve (IOE), dhe Znj Maria Helena André, Zëvendës Sekretare e Përgjithshme e Konfederatës Evropiane të Sindikatave (ETUC). Gjithashtu u shfaq dhe një deklaratë e regjistruar e Presidentit të Komisionit Evropian, Shkëlqesisë së Tij, Z. José Manuel Barroso.

Ministri Portugez i Punës dhe Solidaritetit Social, Z. José Vieira da Silva, u zgjodh Kryetar për Takimin prej 3 ditë e gjysëm.